

**Drejtuar:  
REKTORIT**

**Lënda: DEKLARATË**

<b>Emri / Mbiemri : Studentët e Fakultetit të Artit / Art Muzikor</b>
<b>Adresa: Marshal Tito St</b>
<b>Qyteti : Tetovë</b>
<b>Telefon: -----</b>
<b>E-mail: -----</b>

<b>Autoriteti Publik: Fakulteti i Artit</b>
<b>Adresa: Rruga e Ilindenit</b>
<b>Qyteti: Tetovë</b>

Ne, studentët e Fakultetit të Arteve, Art Muzikor, viti III, deklarojmë se:

Në ditën kritike më date 21.03.2022 gjatë kohës së ligjeratave (të humbur atë ditë) për arsye se profesoresha Besiana Mehmedi është konfrontuar me studentin Ardi Lena duke lëshuar ofendime si e tillë na ka lënduar emocionalisht edhe ne me deklaratat e saja edhe duke na tronditur psikikisht me veprimet dhe sjelljet e saja.

Ne vijim përshkruajmë disa sekuenca të ngjarjes

Ligjërata filloi në ora 14:45 (edhe pse në orar është në 13:30), profesoresha hyri në klasë dhe i pyeti studentët se çfarë kanë mësuar ligjëratarën e kaluar dhe pasi studentët iu përgjigjën, profesoresha iu drejtua studentit Ardi Lena dhe i tha:

Profesoresha: - Ardi na shpjegon për Çesk Zaden dhe Tish Dain!

Ardi Lena: - Nuk e di!

Profesoresha: - Pse se di, për çka duhet mos me ditë?

Ardi Lena: - Nuk e di!

Profesoresha: - Po a ke qenë në orë?

Ardi Lena: - Po!

Profesoresha: - Edhe? Tash a t'fillojmë na krejt klasa t'zërdhahemi?

Ardi Lena: - E drejta juaj, unë s'dërhyj në atë punë!

Profesoresha: - Jo nuk është e drejta jonë!

Ardi Lena: - Po de!

Profesoresha: - Do me than për ty pe di, me dit çka a, me dikan duhet me pas fakte e argumente edhe arsye!!! (ndërkohë që flet profesoresha ardi i pohon me fjalen po).

Ardi Lena: - Po!

Profesoresha: - Mos um thuj ti mu po, po, po, mos mu drejto po, po, po!!!

Ardi Lena: - Po si të drejtohem! E drejta ime është, fejsbukun tem personal e përdor si dua unë!

Profesoresha: - O nuk pom intereson fejsbuku. Kush e përmeni fejsbukun?

Ardi Lena: - Po për cilin, po e di unë ku është çështja.

Profesoresha: - Kush e përmeni fejsbukun?

Ardi Lena: - Po ku jam zërdhi unë?

**Drejtuar:  
REKTORIT**

- Profesoresha: - Halli jotë ka mbet me u zgërdhi me familjart e fëmijun e dikujt!!
- Ardi Lena: - Jo!! Ku jam zgërdhi me fmiun e dikujt!
- Profesoresha: - (dhe me zë të lart i kthehet ardit) Ardi mbylle gojen po t'tham!!!
- Ardi Lena: - Jo jo jo, nuk e mbyll unë kur është padrejtësi, padrejtësi asnjëherë! (ndërkohë që flet Ardi, profesoresha i thotë disa herë: - "mbylle gojën Ardi, dil jashtë").
- Ardi Lena: - Nuk ka mundësi t'më drejtoheni mua profesoresh (me fjalën) mbylleni gojën. Edhe unë ato që i keni shkruar në mesyngjer i kam të gjitha.
- Profesoresha: - Shumë mirë, ruji ruji, tash ta thirri Bajramalin ntelefon e do t'shkoj nrektorat.
- Ardi Lena: - Cilin të duash thirre, nuk keni të drejtë profesoresh mua në atë mënyrë t'më shkruani në fejsbuk.
- Profesoresha: - Nuk ke a një të drejtë, ti mu drejtue me gjuhën që ti ke qef!
- Ardi Lena: - Me cilën gjuhë, unë ju drejtova apo ju më shkruat mua?
- Profesoresha: - Ti ske respekt minimal!
- Ardi Lena: - Për çfarë? Po ju më shkruat mua, a ju kam bërë diçka unë? A ju kam bërë diçka juve?
- Profesoresha: - A ki respekt?
- Ardi Lena: - A ju kam bërë diçka? A ju kam bërë? Është hera e parë në jetën time 22 vjet kam bërë, nuk jam përfolur asnjëher me profesor! Hera parë me juve, me cilin? Më thuaj?
- Profesoresha: - Me Blerimin, me profesoreshën Arjana me secilin!
- Ardi Lena: - A i paskeni bërë domethënë muhabetet a, bravo!
- Profesoresha: - Mu pom tregon muhabetet a, cilin muhabet? (Profesoresha bërtet me zë të lart)
- Ardi Lena: - Mos bërtisni, unë qetë flas, nuk e kuptoj pse bërtisni ju? Jo qetë, qetë, nuk ka nevojë të bërtisni.
- Profesoresha: - (Duke bërtitur me zerin më të lartë) dëgjom tash mu!!!
- Ardi Lena: - Jo, mos bërtisni, unë më së shumti e respektoj veten time!
- Profesoresha: - Nëse ti respekton veten tënde ti mëson!
- Ardi Lena: - Ajo është përgjegjësia ime, une kam ardhur në provim dhe kam rënë. Nuk keni të drejtë të më shkruani në Fejsbukun tim personal dhe të më tregoni se si ta përdor atë!
- Profesoresha: - A ti paske të drejtë a?
- Ardi Lena: - Si ka mundësi të më thoni juve mua "kujdes me fjalët, kujdes me gishtat, vajzën tem. Kur u kam ngacmuar unë te vajza juaj?
- Profesoresha: - I kam të gjitha, do t'i nxjerr, do ju qes në gjyq mbaje mend.
- Ardi Lena: - Ku të doni s'kam gajle unë, nuk kam frikë unë prej asnjërit, jam i drejtë!
- Profesoresha: - Tash unë do ulem dhe ti dil mbaj mësim, hajde çu, çu mbaj mësim a je më i dijshëm
- Ardi Lena: - Jo, unë nuk jam profesor ajo është puna juaj!
- Profesoresha: - Ti a je i vetëdijshëm qysh je tuj vepru, ose dil shpjego ose dil jashtë!!!
- Ardi Lena: - Ju më keni quajtur rrugaq mua, i kam unë në fejsbuk!
- Profesoresha: - Jo unë kam thënë sjelljet e tua janë si rrugaq ndërsa mendimi im për ju ka qënë tjetër!
- Ardi Lena: - Jo unë jam i njëjti s'kam ndryshuar
- Profesoresha: - Ti paske qenë falco, ti ja marr me familjen time!
- Ardi Lena: - Po nxirri nëse ke fakte!
- Profesoresha: - Të gjitha do i nxjerr, të gjitha, turp të kesh, dil përjashta (duke bërtitur)

Studenti del jashtë dhe bisedon në telefon, profesoresha del nga klasa dhe i drejtohet studentit duke i bërtitur dhe i thotë të dal jashtë se do ta thërras sigurimin o rrugaç, pis i keq, dhe për një kohë shumë të shkurtër dalin edhe studentët e tjerë duke mos qenë në gjendje t'i

## **Drejtuar: REKTORIT**

vazhdojnë ligjëratat nga situata e krijuar, ndërsa studentja Erza Shefiti qanë.  
Profesoresha shkon pas studentëve jashtë dhe u thotë:

Profesoresha: - Vazhdoni shkoni në shtëpi dhe për këtë do merremi vesh me të tjerë

Ardi Lena: - Për çfarë do merremi vesh?

Profesoresha: - O pis!

Ardi Lena: - Kujdes me fjalët, pis mua jo!

Profesoresha: - Pis edhe rrugaç!!

Dhe profesoresha duke e ofenduar disa herë studentit në fjalë, duke i bërë presion vazhdimisht, studentit Ardi Lena është mbrojtur nga padëshira e tij por nga sjellja e patolerueshme e profesoreshës në momentin që profesoresha disa herë i ka thënë rrugaç ai ia ka kthyer duke i thënë rrugaçe jeni vet.

Ndërsa pas kërkesës së Shefit të Katedrës studentët janë kthyer në klasë mirëpo profesoresha nuk dëshironte që ligjëratën ta fillojë për arsye se aty ishte dhe studentit Ardi Lena.

Profesoresha i drejtohet studentit Ardi Lena dhe i tregon se ka diplomuar me 9.9 dhe ka magjistruar me 10.0 e i drejtohet:

Profesoresha: - Mos ma bë facen e injorantit, a je tu më degju!

Ardi Lena: - Profesoreshë pse bërtisni unë nuk është që ua kam frikën!

Profesoresha: - Jo, ai që bërtet dhe i ke shqetësuar krejt je ti!!

Ardi Lena: - Jo, asnjëherë!

Profesoresha: - Më fal unë jam tu fol (dhe e godet tavolinën dhe studentja Erza Shefiti çohet në këmbë dhe fillon të qajë)

Erza Shefiti: - Profesoreshë ju lutem a mund të mos piskëllojni (duke qarë)

I gjithë grupi largohet nga ligjëratat ndërsa studenten Erza Shefiti e dërguan në spital pasi nuk ndjehej mirë!

Një rast tjetër ka ndodhur me studentin Rilind Alimani ku ne si grup kemi qenë në prova të korit dhe profesoresha Besiana Mehmedi ishte pjesë e korit. Studenti në fjalë pas tre orësh provash ka kërkuar leje nga profesori i korit që ta lirojë nga provat. Nërsa profesoresha Besiana Mehmedi është çuar në këmbë dhe nuk e lejon studentin të largohet edhe pse ai kishte marrur leje nga profesori. Pasi studentit i kërkoi leje sërish dhe profesori ia jep, ai largohet ndërsa profesoresha Besiana Mehmedi e ndjek nga pas dhe e ofendon duke e quajtur majmun dhe duke i thënë “ti nuk ke kulturë familjare”

Profesoresha në fjalë prej vitit të parë asnjë ligjëratë nuk e ka mbajtur në orarin e caktuar, por ligjëratat janë shtyrë me orë ose me ditë, poashtu edhe provimet.

Mbesim me shpresë se deklarata jonë nga ana e autoritetit tuaj do të merret parasysh dhe si e tillë do të shqyrtohet e analizohet drejtë dhe konsiderojmë se do të marrim përgjigjen e duhur.

Ne mbajmë përgjegjësi morale dhe penale për këto që kemi shkruar.

**Drejtuar:  
REKTORIT**

<b>Emri dhe Mbiemri</b>	<b>Nënshkrimet</b>
<b>Ardi Lena</b>	
<b>Faton Berisha</b>	
<b>Bleron Veliu</b>	
<b>Rilind Alimani</b>	
<b>Inva Abdullahu</b>	
<b>Gurina Salihu</b>	
<b>Lule Ibrahimimi</b>	
<b>Erza Shefiti</b>	
<b>Albana Smajli</b>	

I bashkangjesim edhe materialet e shkruara në rrjete sociale

\_\_\_.03.2022

Tetovë

**Me respekt,  
Grupi i studentëve**